



Informacion për prindër

Të vizituarit e grupit të lojërave (Spielgruppe) me çmim të zbritur

Grupet e lojërave janë vende të rëndësishme të arsimit të hershëm të fëmijëve të vegjël. Qyteti i Bernës i ndihmon fëmijët që të shkojnë në grupin e lojërave edhe atëherë kur familjet e tyre kanë të ardhura të pakta.

Shuma e zbritjes së pagesës për grupin e lojërave varet nga e drejta e reduktimit të premisë së sigurimit shëndetësor (Prämienverbilligung).

Parakushtet për vizitimin e grupeve të lojërave me çmim të zbritur:

- Fëmija i juaj është duke shkuar dy herë në javë në grupin e lojërave ose do të shkojë dy herë në javë me një çmim të zbritur.
- Ju jetoni në qytetin e Bernës
- Nuk jeni duke marr ndihmë sociale (ngase në këtë rast e merr përsipër tërë pagesën socialja)
- Juve u është reduktuar premia e sigurimit shëndetësor 221 franga / 147 franga / 107 franga ose 67 franga në muaj. Lidhur me këtë ju keni marr një vërtetim prej Entit për Sigurimet Sociale të Kantonit të Bernës (shiko shembullin e veçantë)
- Grupi i lojërave është anëtar i FKS - organizata e specializuar dhe kontaktuese grupet e lojërave (Fach- und Kontaktstelle Spielgruppen)

Çka duhet të bëni që t' u mundësohet zbritja e çmimit për grupin e lojërave?

- Pyeteni udhëheqësen e grupit të lojërave për formularin e kërkesës
- E plotësoni këtë
- E dërgoni së bashku me kopjen e shkresës së Entit për Sigurimet Sociale (Amt für Sozialversicherungen des Kantons Bern)

në adresën vijuese:

FKS Spielgruppen Kanton Bern, Kontaktstelle Stadt Bern
Rosfeldstr. 29
3004 Bern

Organizata specializuese dhe kontaktuese grupet e lojërave (FKS) e shqyrton kërkesën tuaj dhe ju kumton, juve dhe grupin e lojërave se a ju mundësohet pagesa me çmim të zbritur dhe se sa është lejuar zbritja e çmimit. Që nga momenti i vendimit pozitiv për zbritje çmimi, grupi i lojërave ju dërgon faturat vetëm me çmim të reduktuar.

Për pyetje vihem me kënaqësi në dispozicionin tuaj.

FKS Spielgruppen Kanton Bern, Kontaktstelle Stadt Bern Tel. 079 517 96 88
(Rea Lehmann)

Orari i shërbimit telefonik:

E martë, 18.30 – 21.00 h, e enjte, 9.00 - 13.00 h dhe e premte 12.00 – 16.00 h

E-maili: bern@fks-be.ch

FKS Spielgruppen (Organizata specializuese dhe kontaktuese grupet e lojërave) – mundëson të vizituarit e grupit të lojërave me çmim të reduktuar nën urdhër të Entit për të Rinjtë të qytetit të Bernës (Jugendamt der Stadt Bern).